

VENDIM
Nr. 331, datë 12.4.2017

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT QENDROR TË MONITORIMIT ON-LINE (SQMO) QË DUHET TË PAGUAJNË SHOQËRITË E LICENCUARA

(Ndryshuar me VKM nr. 648, datë 29.7.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 48, pika 2, 70, pika 12, të ligjit nr.155, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3, të kreut VI, të vendimit nr.647 datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe kritereve të përzgjedhjes të operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit On-line (SQMO) si dhe autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit On-line, që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ministri i Financave vazhdon procedurën për lidhjen e kontratës me shoqërinë e shpallur fituese, sipas kushteve teknike, afateve të implementimit të projektit të përcaktuara në ofertën e shpallur fituese.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LIDHJA 1

Kategoria	Tarifa e mirëmbajtjes	
“Baste sportive”	Tarifa ditore prej 0.70 euro pa TVSH për çdo njësi, ku njësia është çdo qendër basti	Tarifa me përqindje mbi xhiron vjetore që faturon organizatori: 0,5% ose (0,005)
“Lotaria Kombëtare”	Tarifa ditore prej 1.00 euro pa TVSH për çdo njësi, ku njësia është çdo operator	Tarifa me përqindje mbi xhiron vjetore që faturon organizatori: 0.0% (ose 0.000)
“Kazino/kazino të vendosura në hotele me 5 yje”	Tarifa ditore prej 1.25 euro pa TVSH për çdo njësi, ku njësia është çdo aparaturë elektronike	Tarifa me përqindje mbi xhiron vjetore që faturon organizatori: 0.0% (ose 0.000)

